

#00007

INSTITUTI I STATISTIKAVE



**Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë punonjës me kontratë pune në pozicionet:
Supervizorë TI, në njësinë Teknologjisë së Informacionit (TI) për projektin pilot të Censit të Popullsisë dhe
Banesave 2020**

**TITULLI I SHPALLJES SUPERVIZORË TI, NË NJËSINË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (TI) PËR PROJEKTIN PILOT TË CENSIT TË POPULLSISË DHE
BANESAVE 2020**

Termet e referencës:

- Instalon, konfiguron, mirëmban tabletat/paisjet kompjuterike në përdorim nga stafi i terrenit;
- Jep zgjidhje në lidhje me çështjet teknike për problematikat që ndesh stafi i terrenit(anketues/kontrollorë/mbikqyrës);
- Mbështet stafin e terrenit në lidhje me përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit nëpërmjet asistencës teknike;
- Merr pjesë në trajnim;
- Merr pjesë në përzgjedhjen e stafit kontrollor/anketues;
- Sigurohet që të ketë komunikim të vazhdueshëm me stafin e terrenit, Përgjegjësit të Njësisë Bashkiake dhe Drejtuesin e Njësisë së TI të Censit;
- Trajnon anketuesit/kontrollorët për përdorimin e TI;
- Sigurohet që anketuesit/kontrollorët përdorin infrastrukturën e TI sic duhet gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave;
- Raporton çdo problem serioz tek kreu i njësisë TI sa më shpejtë të jetë e mundur;
- U përgjigjet kërkesave të përdoruesve për asistencë. Identifikon burimin e problemit (software/hardware ose gabim anketuesi/kontrollori) dhe zgjidh problemin, e referon dhe e diskuton problemin me Njësinë TI të Censit;
- Kryen detyra të tjera që mund t'i ngarkohen.

Kriteret e përzgjedhjes:

- a - Diplome e nivelit Bachelor ne shkeca te Teknologjise se Informacionit
- b - Preferohet fusha e studimeve Informatikë, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Informatike, ose fusha të ngjashme.
- c - Eksperienca ne fushen e TI perben avantazh

Informacione te tjera:a - Supervizoret kerkohen sipas qarqeve. Ne linkun e mëposhtëm gjeni pershkrimin e punes dhe tabelën e shpërndarjes sipas qarqeve përkatëse.

Aplikantet duhet të specifikojne në CV-në e tyre, qarkun për të cilin aplikojnë.

b- Periudha e punësimit është 6 javë.

Material plotësues

<http://www.instat.gov.al/media/6098/p%C3%ABrshkrim-pune-p%C3%ABr-supervizor-it-p%C3%ABr-cens-2020.pdf>

(<http://www.instat.gov.al/media/6098/p%C3%ABrshkrim-pune-p%C3%ABr-supervizor-it-p%C3%ABr-cens-2020.pdf>)

Afati i aplikimit:8/8/2019

Aplikimi realizohet nëpërmjet faqest së Institutit të Statistikave në seksionin e vëndeve vakante për pozicionet me kontrata të përkohëshme.

Ju duhet të hyni / rregjistroheni më parë në sistem për të aplikuar për këtë pozicion pune (<http://rekrutime.instat.gov.al/aplikant>)